



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë ____/____/____

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 80/2015 “PËR ARSIMIN E
LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË
LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e dy deputetëve,

K U V E N D I
I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin Nr. 80/2015 “PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” të bëhen këto
shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 37 pika 4 të ndryshohet si vijon:

Anëtarët e senatit në institucionet e arsimit të lartë i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së, në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull dhe, për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e institucionit. Në Senatin Akademik përfaqësohen edhe studentët në institucionet publike, në masën pesëdhjetë për qind, ndërsa në institucionet jopublike përfaqësohen në masën e përcaktuar në statutin e institucionit.

Neni 2

Neni 39 pika 2 të ndryshohet si vijon:

Në institucionet publike të arsimit të lartë, ai zgjidhet nga anëtarët e asamblevetë personelit akademik të njësive kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e rektorit llogariten në masën pesëdhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidatët për rektor vetëkandidohen.

Neni 3

Neni 42 pika 3 të ndryshohet si vijon:

Në institucionet publike të arsimit të lartë ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e drejtuesit llogariten në masën pesëdhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidati për drejtues vetëkandidohet. Ai është personel akademik i kategorisë “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij. Kriteret specifike përzgjedhëse të kandidatëve konkurrues përcaktohen në statutin e IAL-së përkatëse.

Neni 4

Neni 48 pika 2 të ndryshohet si vijon:

Bordi i Administrimit përbëhet nga tre përfaqësues të IAL-së, nga tre përfaqësues të Ministrisë së linjës dhe një përfaqësues nga studentët. Në rastet kur njësia e qeverisjes vendore, në territorin e së cilës zhvillon veprimtarinë institucioni i arsimit të lartë, kontribuon financiarisht, së paku në masën prej dhjetë për qind të buxhetit afatmesëm të IAL-së, atëherë një prej përfaqësuesve, që i takon ministrisë përgjegjëse për arsimin, përcaktohet nga njësia e qeverisjes vendore.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletore zyrtare”.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI